



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .05.2022

**MBLEDHJA Nr. 21,**  
**Datë 19.05.2022, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 19.05.2022, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 21 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 09.05.2022
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Prill 2022
3. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “PPC Albania” sh.a., me nr. 373, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017
4. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Tamara Hydro Energy” sh.p.k. për licencim, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
6. Mbi pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur të vendimit nr. 110, datë 26.04.2021, për depozitimin në ERE të lejes mjedisore të rinovuar, të shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC-i Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërisë “HEC-i Tërvolit” sh.p.k.
8. Mbi kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. (FTL sh.a.)
9. Mbi miratimin e rregullores së përdorimit të terminalit të gazit natyror

10. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së tarifës së depozitimit të gazit natyror
11. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**